

Përshkrim i romanit “Nëpër shtigjet e ferrit”

nga mësuese Rudina Llazari

Libri “Nëpër shtigjet e ferrit” i Viktor Martinit është një dëshmi tronditëse mbi vuajtjet e njerëzve të përndjekur nga regjimi komunist në Shqipëri. Vetë titulli ka një ngarkesë simbolike: “shtigjet e ferrit” krijojnë paralelizëm me ferrin dantesk, duke paralajmëruar lexuesin se rrugëtimi i autorit do të jetë një kalvar dhimbjesh, burgjesh, humbjesh dhe mbijetese. Titulli, krijon kështu një atmosferë të rëndë emocionale.

Shprehja “në shtigjet e ferrit” nuk është vetëm metaforë artistike, por përmbledh në mënyrë simbolike rrugën e gjatë të vuajtjeve, torturave dhe poshtërimeve që autori ka kaluar gjatë jetës së tij. “Ferr” këtu nuk paraqitet si një koncept abstrakt, por si një realitet konkret: qelitë e burgjeve, hetuesitë çnjerëzore, frika e vazhdueshme, izolimi dhe humbja e lirisë njerëzore.

Nuk kemi të bëjmë me një roman të trilluar, por me një letërsi memuaristike, ku rrëfimi shërben si dokument, dëshmi dhe kujtesë historike. Viktor Martini nuk shkruan si romancier që ndërton trillime artistike, por si dëshmitar i drejtpërdrejtë i historisë. Pikërisht kjo e bën veprën më të fuqishme dhe më tronditëse. Ngjarjet rrëfohen me realizëm të thellë dhe me një ndershmëri që prek lexuesin.

Nëpërmjet kujtimeve personale, autori na njeh me fatin tragjik të familjes së tij, e cila u godit rëndë nga regjimi komunist për bindjet dhe prejardhjen e saj.

Në shtigjet e ferrit i Viktor Martini, një rrëfim autobiografik që sjell para lexuesit dramën e një individi dhe të një familjeje të përballur me egërsinë e diktaturës komuniste në Shqipëri.

Që në parathënie, autori paralajmëron se ngjarjet do të jenë të dhimbshme dhe prekëse. Dhe vërtet, libri të godet jo vetëm për atë që tregon, por sidomos për mënyrën e thjeshtë e të drejtpërdrejtë me të cilën rrëfen. Nuk ka zbulime artistike të tepërta, nuk ka romantizim të vuajtjes; gjithçka paraqitet lakuriq, si një dëshmi që kërkon të mos harrohet. Kjo e bën rrëfimin edhe më të fuqishëm.

Në qendër të librit është vetë Viktori, djali i një ish-oficeri të Mbretit Zog, Zef Martinit i cili vdes në burg, e nuk iu ka gjendet as trupi edhe sot.

Që fëmijë, ai përballet me peshën e biografisë së keqe dhe me egërsinë e sistemit. Një nga shprehjet që përsëritet shpesh në libër: “Çka del prej maces, gjuan minj”, tregon mentalitetin përjashtues të diktaturës, ku faji trashëgohej dhe ku fëmijët dënoheshin për bindjet apo prejardhjen e prindërve.

Një nga figurat më prekëse është Nana Katerinë, simbol i nënës shqiptare të sakrificës. Ajo mbetet një grua stoike që ndjek katër djemtë burgjeve, që nuk ha vetë për t’u çuar bukë fëmijëve dhe që jeton mes dhimbjes e shpresës. Figura e saj e tejkalon dimensionin individual dhe bëhet

përfaqësuese e mijëra grave shqiptare që mbajtën mbi supet tragjedinë e familjeve të tyre gjatë komunizmit. Vdekja e saj është ndër momentet më emocionuese të veprës.

Libri ka vlerë të madhe edhe sepse sjell psikologjinë e një fëmije të rritur nën terror. Viktori, vetëm 11 vjeç, arrin të kuptojë se jeta e tij do të jetë e mbushur me pengesa. Në një moment ai shprehet: “Se rrugët e jetës do t’i kisha të vështira e se gogoli sistem do më ndiqte në çdo hap, gjithë jetën.” Ky mendim, i dalë nga mendja e një fëmije, e bën rrëfimin edhe më dramatik.

Autori ndalet edhe te izolimi shoqëror. Në shkollë ai përballlet me përçmimin dhe diferencimin, megjithëse gjen edhe mësues njerëzorë. Episodi kur refuzon të këndojë ditën e premte para Pashkëve dhe dënohet për këtë, tregon sesi regjimi kërkonte të kontrollonte jo vetëm jetën politike, por edhe ndërgjegjen dhe besimin fetar.

Një pjesë me vlerë e librit është përshkrimi i burgjeve dhe kampeve të punës.

Qelitë, hetuesia, torturat, uria, të ftohtit dhe ankthi përshkruhen me realizëm të ashpër. Momenti kur Viktori arrestohet për herë të parë në moshën 16-vjeçare është tepër dramatik. Ai ndodhet mes dilemës morale: të tregojë për tentativën e arratisjes së shokut dhe të quhet spiun, apo të heshtë dhe të dënohet vetë. Kjo e bën personazhin më njerëzor dhe tregon konfliktin e brendshëm që krijonte diktatura tek individit. Një dimension tjetër i rëndësishëm është galeria e personazheve reale që autori sjell në libër: të burgosur politikë, intelektualë, klerikë dhe nacionalistë.

Veçanërisht domethënës është takimi me Padër Mëshkalla

Takimi me Padër Meshkallën përbën edhe çelësin ideor të gjithë veprës. Fjalët e tij drejtuar Viktorit: ***“Ti ke me kenë dëshmitar i vuajtjeve tona. Në emër të Zotit të ngarkoj me detyrën e dëshmitarit”***, japin arsyen pse është shkruar ky libër.

Qëllimi nuk është hakmarrja, por dëshmia. Kujtesa bëhet mision.

Me shumë forcë autori sjell edhe atmosferën e burgut të Burrelit, të cilin e përshkruan pothuajse si “porta e ferrit” të Dantes. Aty ai njeh figura të njohura si Gjergj Kokoshi, Brahim Biçaku, Xhevat Korça, njerëz që regjimi i kishte shpallur armiq.

Në burg, paradoksisht, ai formohet edhe intelektualisht, pasi shumë të burgosur të shkolluar jashtë vendit u mësojnë të rinjve gjuhë të huaja dhe kulturë.

Pas lirim, kalvari nuk përfundon. Viktori vazhdon të ndiqet, tëurvejohet dhe të përjashtohet nga jeta normale. Arrestimi i dytë, torturat çnjerëzore, përpjekja për ta kthyer në spiun dhe madje tentativa e tij për të luajtur rolin e të çmendurit, tregojnë se sistemi nuk mjaftohej me dënimin fizik; ai synonte thyerjen morale të individit.

Një nga mesazhet më të forta të librit gjendet në fund, kur autori thotë se fëmijëve nuk ua kanë fshehur kurrë historinë e vuajtjeve të tyre, sepse ata do të ishin “trashëgimtarë të vuajtjeve tona”. Kjo fjali e shndërron librin në një testament kujtese për brezat e rinj.

Një tjetër vlerë e madhe e këtij libri është rëndësia historike dhe edukative. Për brezat që nuk e kanë jetuar periudhën e diktaturës, kjo vepër shërben si një dokument i gjallë për të kuptuar terrorin politik dhe mungesën e lirive themelore në atë kohë. Libri nuk është vetëm histori personale; ai është pasqyrë e fatit të mijëra shqiptarëve të përndjekur nga regjimi. Përmes tij kuptojmë se diktatura nuk godiste vetëm individin, por tërë familjen, duke i privuar njerëzit nga dinjiteti, e drejta dhe shpresa.

Në shumë pjesë të veprës ndihet edhe mesazhi moral i autorit: nevoja për të mos harruar të kaluarën. Kujtesa historike është një detyrim ndaj atyre që vuajtën dhe sakrifikuan, sepse harresa do të ishte një padrejtësi e dytë ndaj atyre që kaluan nëpër “shtigjet e ferrit”. Në këtë kuptim, libri bëhet një akt dëshmie dhe ndërgjegjësimi shoqëror. Ai na kujton se liria dhe të drejtat njerëzore nuk janë të dhëna përgjithmonë, por duhen mbrojtur vazhdimisht.

Në përfundim, “*Nëpër shtigjet e ferrit*” është një vepër me vlera të mëdha historike, njerëzore dhe letrare. Ajo nuk mbështetet te trillimi artistik, por te fuqia e së vërtetës. Libri të trondit sepse tregon sesi diktatura shkatërroi jetë, familje dhe fëmijëri, por njëkohësisht të bën të admirosh forcën e njeriut për të mbijetuar dhe për të dëshmuar.